

Leje kalimi

Për t'u pajisur me leje kalimi, duhet që ju të aplikoni on-linë përmes internetit (nga një celular, tablet apo një kompjuter) në portalin www.e-albania.al.

Për të vijuar me aplikimin elektronik, klikoni në lidhjen si më poshtë:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9489

Leje kalimi për të mitur dhe shtetas nën 18 vjeç.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Pasaportë e pavlefshme ose vërtetim/denoncim i humbjes ose vjedhjes nga autoritetet policore greke
- Kartë identiteti origjinale (ose)
- Certifikatë lindje nga gjendja civile përkatëse (edhe e lëshuar nga autoritetet e huaja e apostiluar ose legalizuar)
- Akti i lindjes i spitalit i certifikuar (apostilim ose legalizim)
- Paraqiten fëmija i shoqëruar nga të paktën njëri prind me pasaportë (na rast divorci paraqitet prindi që ka kujdestarinë prindërore ose kujdestari ligjor me prokurë nga të dy prindërit dhe dokument që tregon të qenurit kujdestar ligjor)
- Dy foto të formatit 4cm x 5cm me sfond të bardhë
- Mandat pagesa

Leje kalimi për shtetasit mbi 18 vjeç

Theksojme se Leje kalimi për shtetasit mbi 18 vjeç jepen në rastet kur shtetasi shqiptar i ndodhur jashtë shtetit ka humbur pasaportën, ose për arsye të ndryshme nuk disponon një pasaportë të vlefshme për udhëtim.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Pasaportë e pavlefshme ose vërtetim/denoncim i humbjes ose vjedhjes nga autoritetet policore greke (ose)
- Kartë identiteti origjinale (ose)
- Çertifikatë lindje e shoqëruar me kopjen e kartës së identitetit (nëse ka)
- Leje Drejtimi Automjeti, format i ri elektronik (nëse ka)
- Dokument që tregon të qenurit kujdestar ligjor
- 2 foto me përmasa 4×5 cm, dhe me sfond të bardhë;
- Mandat pagesa

Tarifa e shërbimit

Tarifa konsullore për Lejet e Kalimit është 30 euro. Pagesa mund të kryhet me çdo lloj kartë bankare nëpërmjet aparaturave POS të instaluar në Zyrën tonë Konsullore ose me kartëmonedha (CASH) në bankomatit pranë Ambasadës, të përshtatur në gjuhën shqipe.